



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:287812  
Datë: 13.03.2025  
Numri i dokumentit: 06985789

Ac.nr.728/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Bujar Dobërdolani dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. (H.) J. nga F., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Ramadan Sylejmani nga Ferizaj, kundër të paditurve S. Z. nga fsh.B. K.F., A.D.nga F., të cilin sipas autorizimit e përfaqëso av.Vllaznim Aliaj nga Ferizaj, B. J. nga F., L.S. nga fsh. S.,K.V. të cilin sipas autorizimit e përfaqëso av.Dardan Hakiu nga Ferizaj, me objekt kontesti vërtetimin e së drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të katërt, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1459/19 të datës 08.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 05.03.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

HEDHET poshtë si e pas afatshme ankesa e të paditurit L. S. nga fsh. S., K.V., ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1459/19 të datës 08.11.2025.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.1459/19, të datës 08.11.2025, ka vendosur në këtë mënyrë: NDËRPRITET PROCEDURA në këtë çështje juridike të paditësit B. (H.) J. nga F., kundër të paditurve S. Z. nga fsh.B. K.F., A. D. nga F., B. J. nga F., L.S. nga fsh. S,K.V, në çështjen juridike për vërtetim pronësie, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake. Paditësi udhëzohet se mund ta kërkojnë vazhdimin e procedurës kontestimore pas plotësimit të kushteve ligjore sipas nenit 280 të LPK-së.

Kundër këtij aktgjykimi pas afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri përmes të autorizuarit të tij për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktvendimi e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthen në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa e të paditurit është e pas afatshme.**

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar fillimisht lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës së ushtruar, nga pala e paditur konstatoi se e njëjta është ushtruar pas skadimit të afatit të paraparë ligjor prej 15 ditësh.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se Aktvendimin ankimor C.nr.1459/19 të datës 08.11.2021, i autorizuari i të paditurit e ka pranuar me datë 02.12.2021, kjo vërtetohet nga fletëkthesa e të njëjtës datë, në të cilën figuron nënshkrimi i marrësit, ndërsa ankesa e ushtruar nga i paditurit përmes të autorizuarit të tij ndaj aktvendimit të atakuar është dorëzuar në gjykatës e shkallës së parë me datë 21.12.2021 në ora 09:30.

Nga momenti i pranimit të aktvendimit nga i autorizuari i të paditurit, me datën 02.12.2021 e deri më datën e parashtrimit të ankesës të dorëzuar në gjykatën e shkallës së parë me datë 21.12.2021, kanë kaluar gjithsej 19 ditë, që nënkuptohet se ankesa është ushtruar 4 ditë pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, ngase si datë e fundit për ushtrimin e ankesës në rastin konkret ka qenë data 17.12.2021 e që bie ditë e premtë (ditë pune).

Meqenëse, hudhjen poshtë të ankesës si të pas afatshme nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 186 paragrafi 1 dhe 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e pas afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe nenit 195, par.1, pika (a), ku përcaktohet që gjykata e ankimit ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, si dhe nenit 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se këtë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, siç është parashikuar në nenin 186 par.1 dhe 2 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë në kuptim të nenit 208 dhe 209, pika (a) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.728/2022, datë 05.03.2025

Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi

Numri i lëndës: 2019:287812  
Datë: 13.03.2025  
Numri i dokumentit: 06985789